



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.282/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohen si të bazuara ankesat e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Anr.282/2014 dhe Anr.283/2014 të datës 09.06.2014 dega në Prizren, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 6750 (gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 09.06.2014, ka pranuar ankesat Anr.282/2014 dhe Anr.283/2014, nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 08.06.2014, në ditën e heshtjes zgjedhore kandidati për deputet i subjekti politik PDK, Blerim Rexha, ka shpërndarë sms për të kërkuar votën e qytetarve.

- Sipas ankesës Anr.282/2014, pretendohet se me datën 08 qershor 2014 aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje nga Qendra në Prizren, konkretisht aktivistit Karanfil Haxhillari rreth orës 16:39, në telefonin e tij ju ka dërguar një sms për të votuar Blerim Rexhën nga subjekti politik PDK.
LVV pretendon se me këtë veprim subjekti politik PDK, ka bërë shkelje të nenit 7.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së, dhe Kodit të Mirësjelljes për Subjekte politike, neni 36.1 të pikës b të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.
Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi si dëshmi, në të cilat shihet dërgimi i mesazhit nga subjekti politik PDK.
- Sipas ankesës Anr.283/2014, pretendohet se me datën 08 qershor 2014 rreth orës 16:44 aktivisti i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), ka raportuar se në numrin e tij personal i ka ardhur një sms me përmbajtje për përkrahjen e subjektit politik PDK dhe në mesazh është inkurajuar votimi i PDK-së dhe votimi i kandidatit të tyre për deputet Blerim Rexhaj.

LVV pretendon se me këtë veprim subjekti politik PDK, ka bërë shkelje të nenit 8.1 pikës c të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografimin e sms të dërguar në numrin personal të Karanfil Haxhillari.

- PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, informoi subjektin politik PDK, me datë 10.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 11.06.2014, deri në ora 10:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën thekson se PDK dhe kandidati për deputet Blerim Rexha, hedhë të gjitha këto trillime si të pavërteta. Sipas përgjigjes në ankesë, lidhur me pretendimin në ankesë nuk ka asnjë fakt të vërtetë dhe qëllimi i kësaj ankese është që ta shantazhoj PDK-në dhe kandidatin në fjalë, pasi që fotografia e bashkangjitur në këtë ankesë nuk dëshmon asnjë fakt lidhur me ankesën e pretenduar nga LVV.

Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit – përcaktohen bazuar në Nenin 36.1 të LZP-së dhe Nenin 7.1 të Rregullës Zgjedhore 11/2013 në të cilat specifikohet se :

Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;

b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:
c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;

- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se padyshim subjekti politik PDK, ka thyer heshtjen zgjedhore, në mënyrën siç pretendohet në ankesat e paraqitura. Një gjë e tillë shihet nga fotografia e telefonit të ankuesit sms i pretenduar në ankesë, nga i cili rezulton se kandidati i PDK-së Blerim Rexha ka dërguar gjatë heshtjes zgjedhore sms me këtë përmbajtje:

Po ju nëse votoni PDK 58. Votoni për deputet. Blerim Rexha 98. Sms i është dërguar tek Karanfil Haxhillari në ora 16:39 të datës 08.06.2014.

Bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c), të LZP-së, përcaktohet çart se në rast se ka ndodhur shkelja e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së, PZAP-i mund të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në lartësi deri në 50000 euro. Sipas Rregullës Nr.01/2012 për “*Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave*”, neni 6 par.2 specifikon se “*në çoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë fushatë në çfarëdo mënyre 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre subjekti politik që është i përfaqësuar në kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet më gjobë nga 6500 euro deri në 25000 euro*”.

Duke marr parasysh se subjekti politik i lart përmendur, ka bërë thyerje të heshtjes zgjedhore në mënyrën e lartpërmendur, duke përsëritur tri herë radhazi shkeljen e njëjtë, dhe se përsëritja disa herë e të njëjtës shkelje pa tjetër ndikon në lartësinë e gjobës, PZAP-i, duke vlerësuar edhe rrethanat tjera të lartpërmendura që janë me ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar, të njëjti subjekt i shqipton gjobën e lart cekur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.282/2014 më datën 12.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*